

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NEXUS-131” SHPK

Ortaku themelues si më poshtë:

- **Z. Ardit Bajraktari**, shtetas shqiptar, i biri i *Beharit*, i datëlindjes 01.09.1990, lindur në Polican dhe banues në Tirane, rruga "Medar Shtylla", Nd. 48, H. 30, Ap. 12, mbajtës i letërnjoftimit me nr personal J00901005M,

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), sot më datë 06.02.2025, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin "**NEXUS-131**". Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma

Shoqëria tregtare "**NEXUS-131**" ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**NEXUS-131**" SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën rruga "e Kavajës", ZK. 8350, godinë polifunksionale, me Nr. pasurie 6/8, katë i shtatë, Tirana Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në fushën e administrimit dhe mirëmbajtjes e menaxhimit te ambjenteve te strukturave ndërtimore si:

- Mirëmbajtje rutinë e strukturave ndërtimore, ambjenteve, ndërmarrjen e kontolleve periodike, teknike dhe higjeno-sanitare per gjendjen e strukturës ndërtimore.
- Administrimin në mënyre ekskluzive të strukturave ndërtimore, ambjenteve, si dhe drejtimin e përgjegjësine per securinë dhe funksionimin e këtyre ambjenteve.
- Mbikqyrjen, drejtimin e aktivitetit te përditshëm, te strukturave ndërtimore dhe kryerjen dhe realizimin ne mënyre efikase dhe me kujdesin e duhur, si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm qe ka të bëjë aktivitetin e shoqërisë.
- Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera, vendase apo të huaja, për përbushjen e objektit të aktivitetit të saj.



NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “**NEXUS-131**” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortaku/ët nuk përgjigjet/n për detyrimet e shoqërisë “**NEXUS-131**” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**NEXUS-131**” SHPK është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetëm Ardit Bajraktari, i cili zoteron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 100,000 (njëqind mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind përqind) në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë do të jetë ortaku i vetëm Ardit Bajraktari.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortaku/ët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “**NEXUS-131**” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.




NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksonit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

ARDIT BAJRAKTARI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Ardit Bajraktari", is enclosed within a large, roughly drawn oval shape.